



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 10 datë 31.03.2026

PËR

“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 31.03.2026, sipas procedurës së përcaktuar në nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin e projektregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë, si më poshtë:

1. Projektregullore “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”;
2. Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara pas këshillimit publik të Projektregullores “Për zbatimin e e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”;
3. Projektvendimi i arsyetuar;
4. Relacioni shoqërues i Projektvendimit,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 31, datë 22.12.2025, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, që do të shfuqizojë rregulloren nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm” në fuqi si dhe do të reflektojë përcaktimet e neneve 20, 26, 27, 29 dhe 30 të ligjit nr. 54/2024, të cilat rregullojnë regjimin e autorizimit të përgjithshëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
2. Mbështetur në parashikimet sa më sipër, është synuar që të miratohet me rregulloren e re, forma dhe përmbajtja e njoftimit, dokumentacioni mbështetës si dhe konfirmimi i regjistrimit të njoftimit, duke marrë në konsideratë rekomandimet e BEREC, parashikimet e akteve të tjera ligjore e nënligjore që prekin apo ndërthuren me fushën e komunikimeve elektronike.
3. Projektregullorja “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, u publikua në faqen zyrtare të AKEP, më datë 23.12.2025, dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 06.02.2026. Në përfundim të procesit të këshillimit publik pranë AKEP, janë depozituar komente nga palë të interesuara, konkretisht:
 - Sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., protokolluar në AKEP me shkresën nr. 135, datë 03.02.2026.
 - Sipërmarrësi “Abissnet” sh.a., protokolluar në AKEP me shkresën nr. 163 prot., datë 06.02.2026.
 - Sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., protokolluar në AKEP me shkresën nr. 176, datë 09.02.2026.
 - Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në rrugë elektronike në datë 20 shkurt 2026.
4. AKEP pas vlerësimit të komenteve të palëve të interesuara lidhur me projektregulloren “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, të nxjerrë në këshillim publik, ka përgatitur si më poshtë:
 - “Rregullore “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, që përbën dokumentin përfundimtar pas procesit të këshillimit publik, si dhe “Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të projektregullores “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”.

5. Projektregullorja “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, është përgatitur nga AKEP në kuadër të hartimit të akteve nënligjore përkatëse të nevojshme për zbatimin e ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, pas një procesi të këshillimit publik duke marrë në konsideratë komentet e palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, si dhe Qëndrimin e AKEP lidhur me komentet e palëve të interesuara, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuara në pikën 1 të tij, publikohen në faqen zyrtare të AKEP: www.akep.al.
3. Ngarkohet administrata e AKEP, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka